

Nr/Bр 01-163  
Me/Dena 18.03.2019

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës  
Z/znj. \_\_\_\_\_

Në bazë të dispozitave te nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si  
dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e tret të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë:  
28.03.2019 (e enjte) duke filluar në ora 10:00.

R e n d i d i t ē s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i Raportit Financiar tremujor të katërt Tetor - Dhjetor 2018;
3. Aprovimi i Raportit Financiar Vjetor 2018;
4. Raporti i drejtoris së Arsimit mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë për vitin shkollorë 2018/19;
5. Aprovimi i propozimit për bartjen e mjeteve të pa shenuara nga të hyrat vetanake nga viti 2018/19;
6. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 18.03.2019  
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic  
Kryesues i Kuvendit

*Nebojsa Arsic*



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

### KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

#### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 28.02.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhu, Dobrivoje Djordjevic, Xhejlane Behluli, përfaqësuesit i OSBE-es, përfaqësuesit e Kfor-it, zyrtar dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendetë të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 12 antarët të Kuvendit dhe kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

#### Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Aprovimi i Raportit Financiar tremujor të katër Tetor- Dhjetor 2018;
3. Aprovimi i Raportitit Financiar Vjetor 2018;
4. Aprovimi i Draft Planit për Menaxhimin e Mbeturinave;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit tha: se sa i përket pikave të rendit të ditës për arsyen se jemi ne fillim të vitit 2019 duhet që Kuvendi të bjen vendim si vitin e kaluar për mbushjet telefonike për Kryesuesin, zv.Kryesuesin, Antarët e Kuvendit dhe dy zyrtarë të Kuvendit, vlera e mbushjeve mujore për Kryesuesin dhe zv. Kryesuesin do të jetë 20€ ndërsa për antarët dhe dy zyrtarë vlera nga 10€ ku gjithsej do të janë 580€, po vazhdojm ne me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Bajrush Ymeri pasi përshendetë të gjithë të pranishmit tha: në cilësi të Nënkyetarit të Komunës natyrish edhe si Kryetar i Lidhjës Demokratik të Kosovës dega në Novobërdë po e paraqes një kërkesë timen siç edhe e din këtë kërkesë e kam paraqitur edhe më herët, ka të bëj me dy antarët e të LDK-s, siç edhe e dini që dhjetë muaj KQZ-ja e ka bllokuar mos certifikimin e antarëve nga Presidenti i vendit ,si rezultat i kësaj antarët e Kuvendit po presin që gjashtë muaj për zavendësim, ky ras deri me tani nuk ka ndodhë as një herë në histori që nga viti 2000 kemi mbajt zgjedhje lokale as një herë nuk ka ndodhë mos zavendësi këq gjatë të antarve të rindë i tërë procesi i KQZ-së duke filluar me numrimi dhe rezultatet e zgjedhjeve kan dal me rezultate si dhe kan paraqit një listë e cila është e hapur në internetë ,pastaj kan bërë certifikimin e zgjedhjeve ,dhe nuk e di se pse nuk zavendësohen këta antarë të kuvendit Komunal. Zotri Kryesues e fundja këta antarë kanë me dhënë betimin para juve para këtyre antarve, kan me kry shërbim për qyteratë të cilët i kan votu këta antarë, antarët e rindë betim e jepin para juve jo para presidentit. Zt.Ymeri gjithashtu kërkoj kryesuesit, antrëve të kuvendit që të hudhët ne pikë të rendit të ditës betim i antarëve të rindë, është

## Procesverbali i Kuvendit

e padrejtë kjo që ju bëni subjktiti tim politik edhe pse e din qe jemi parti me e votuar, kemi marr tri ulse ne kuvende kurse sot nuk e gjozm të drejten për këto tri ulse. Gjithashtu zotri Ymeri propozoj dhe kërkoj nga Kryesuesi i Kuvenditë ta parqaes para antareve të Kuvendit si pik të rendit të ditës dhënja e betimi të antarve të rinjë edhe pse nuk është e kundër ligjshme, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: se e di qe problemi është në KQZ-ën kurse me të vertete pa me arrit raporti nga KQZ-ja për verifikimi e të gjithë antarëve, e tërë kjo që po thua të bëjmë është kundër ligjorë, ne nuk kem mandatë ligjorë të bëjmë punë e dikujt tjetër, vendim vjen nga KQZ-ja. Nga konferanca e fundit përfaqësuesit të qendrave të Kosovës që kemi pas të njetin problem qendron edhe me komunat tjera, afër 10 komuna të Kosovës kan të njetin problem dhe të gjithë kan thënë se ne nuk mundemi të bëjmë asgjë, pa KQZ-ën, une prap sot ju them se nese ne bëjma diqka nga dora jom pa çertifikimin e KQZ-së kjo do të jetë kundërligjore gjithashtu edhe po të biem vendim do të na kthehet kundër edhe nga Ministria Pushtetit Lokal .Unë porpozoj që kjo pik e rendit ditës të mos jete propozim në rend dite.

Bajrush Ymeri tha: unë jam i bindur që po te bijmë këtë vendim me ju leju antarëve të Kuvendit Komunal me dhënë betimin nuk është kurfar shkelje sepse edhe neser keta njerz çertifikohen këta antarë kan me ardhë, nuk kan me ardh të tjerë, por edhe atëher kam kërkuar ta fusim si pik të rendit të ditës nuk e keni hudhë, por është mire të hudhet si pik e rendit të ditës le te delkarohen antarët e kuvendit me shumice votash nëse votojn për me hjeke e hjekm, votojn për me futë e fusim, në të kundërtën Ymer tha se në shenj proteste jam i obliguar të kërkoj prej antarëve të mi të subjekti tim ta lëshojn mbledhjen, ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit tha: une prap po e përsoris se po se e bëjm kjo qëndron kundër ligjore ,unë këtë pik nuk e hudhi në rend të ditës.

Ivica Cenicpasi përshendetë të pranishmit tha: kërkoj që pika e rendit te ditës Aprovimi i Raportit Financiar tremujor të katër Tetor- Dhjetor 2018; si dhe pika e tretë Aprovimi i Raportit Financiar Vjetor 2018 që këto pika të rendt ditës ti shtyjm për mbledhjen e ardhëshmë, për arsy se nuk e kemi marr materialin me kohë dhe nuk e dim as për qfarë bëhët fjalë, ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit tha: kemi pasë problem me përkthimin, kemi pas verzionin shqip, por nuk e kemi pas verzioni sérbisht, gjithashtu edhe asistentja jon qendron në pushim dhe kjo është e tëra që nuk kemi mund t'ju dërzojm me kohë. Kryesuesi hudhi në votim dhe me 9 vota për dhe një apstenim keto pika të rendit ditës shtyhen për mbledhjen e ardhëshme.

Pasi pat diskutime tjera rendi i ditës u aprovohet rendi i ditës njëzëri nga të gjithë anatarët prezent të Kuvendit me terheqje te këtyre dy pikave.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pat vëretje procesverbali u aprovua me 9 vota për nga antarët prezent të Kuvendit.

**Pika e katër :** Aprovimi i i Draft Planit për Menaxhimin e Mbeturinave

Kryesuesi tha: se në këtë mbledhje duhet ta aprovojm Draft Planit për Menaxhimin e Mbeturinave i cili vjen për menagjimin e mbeturinave, plani vjen në kuadër të projektit të GIZIT i cili gjithashtu do të ndihmojë Komunës për mirëmbajtje të ambientit, për furnizim me kontinjer, andaj ftoj z.Bajram Abazi ta prezentoj Draft Planit për Menaxhimin e Mbeturinave.

Bajram Abazi pasi përshendetë të pranishmit filloj me prezantimin e palnit 2019-2023 palni është financur nga GIZI Gjerman z.Abazi prezentoj edhe fillimin e punës së këti plani qysh në vitin 2018 ,duke filluar me fokus grupen punuëse të cilëtë janë:Kryesuesit e grüpuit zonja.Shekije Mehmeti, antarët Goran Kostiq ,Bajram Abazi,Goran Maksiomovic ,Sergjan Todorovic ,Naser Ibrahim si dhe Sadbere Vllasaliu z.Abazi fillo me prezantimi e projekteve konkrete te këti plani të furnizojm komunën me 500 kontinjera 2019, për 2020 kem të planifikuar për blerjen e kamijonit e kapacitet 7 ton, Kontenjera të plastikës 240 lit, Rregullimi i hapësirës - bazamentit dhe rrrethojave për vendosjen e ishujve të gjelbër, Kontenjera të plastikës 1.1 m<sup>3</sup>, Kontenjera të plastikës 120 lit 120 copa, Kontenjera për kompostim 30 copa per 2021, Ndërtimi i qendrës për pranimin riciklin, Kamion kompaktues me kapacitet ngarkues 4.5 ton për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave, Kontenjera për kompostim 30cop, Ndërtimi i qendrës për

## Procesverbali i Kuvendit

pranimin riciklimin dhe transferin e mbeturinave ndërtimore vëllimshme dhe mbeturina tjera. Për 2022 dhe 2023 Kontenjera për kompostim 30cop, Kontenjera të plastikës 120 lit, këto jan që do të financohet në bazë të donatorve dhe në bazë të mundësive buxhetore të komunës .

Naser Ibrahim Menaxher i Eko Higjenës pas pëershëndeti të pranishmit dhe faleminderoj edhe GIZIN Gjerman për financimi e këti projekti tha: ky projekt është në të mirën e Komunës Novobërdës , nëse realizohet ky projekt është e vërtetë që duhet të partiçipoj edhe Komuna, në takimet që kemi pas e kem diskutuar që edhe Komuna ka munges bugjetore ka bugjet të vogël, e mira e këti plani është që ne tani kemi dokumet për aplikim të grandëve në Ministrin e Ambijetit, ne deri tani nuk kem mundur me apliku për grande pa pas këtë plan andaj ju kërkojë përkrahjen tuaj, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti pas pëershëndeti të pranishmit tha: e përgëzoi komisionin këtë punë që kanë bërë si dhe faleminderoj organiztën GIZ për një projeket të tillë. Zt.Mehmeti kërkoj që ne faqën e parë të hiqët këti drafti ku shifte gjithvotimi i Kryetarit të Komunës, me len të mendohem shum këtë e them mem faktin që komuna e Novobërdës i ka mbi 80.000€ borqë Ecco Higjenës nuk ka qenë i gatshëm me ja paguar shpenzimet që i kan kry shërbimet kjo kompani, por është detyru që përmes përmbaruesit privatë me nxjerr paratë nga Kryetari i Komunës që si kryen obligimet e veta ndaj një kompanije që i ka kryer shërbimet nuk di qka medohet tutje. Zt.Mehmeti parashtroj edhe disa pytje, se komisioni a ka antarë Ecco Higjena në bordin përfaqësuë nga komuna jonë e nëse nuk ka pse nuk ka si dhe a jeni konsultuar me bugjetin e komunës dhe përfaqësuesi i Urbanizit pse nuk është pjesë e këti plani duke e parë edhe vleren e këti plani ku është 45.000€, dhe a jeni kosultu me komunë me zyrtarë si do t'ju financojn, ju faleminderit.

Naser Ibrahim tha: ne antarë të bordit për Kompanin Eko Higjenës nuk kem arsyë është pse ne nuk kemi një marveshje afat gjatë me Kompanin dhe Komunën kurse komua e Gjilanit,Kamenica dhe Vitia e kanë përfaqësin bordë dhe marveshjen afat gjatë ata e kan prej 10 deri 15 vjetë, ne nuk kemi mundësi finaciar nuk kemi mundësi edhe ti mbulojm shpenzimet edhe për një antarë te kemi në bord, ne edhe pse nuk jem në bordë as nje herë nuk e kemi lënë keq qytetarët, me njejt i gezojm të drejtat si komunat tjera, kurse te bugjeti jemi konsultuar me Drejtorin e shërbimeve publike dhe zyrtarin e ambijentit, por bugjeti i vogël i komunës për mundësi, pikërisht për këtë neve na ka përkrahur GIZI, ne me këtë plan dhe projekt do të kërkojm donator, ka edhe grande tjera, vjet jan dhën mbi 8.000.000 për mirëmbajtje të ambijeti në tërë teritorin e Kosovës, ne nuk kemi mundur të aplikojm pa e pasë këtë plan dhe besoj që nëse marmi përkrahjen nga ju nga komuna, gjithashtu ju e ceket që ne me keqardhje themi se edhe qytetarët I kemi dërguar të përmabruësi edhe pse shum do të jete edhe për qytetarin dhe komunë ma e madhe kur dërgohet te përmarësi ,po ne prap duhet dhe do të punojm me këto të hyra sa do të vogla që janë.

Abdyl Gashi pasi pëershëndeti të pranishmit tha: ne e mbështesim këtë plan se ka qen i nevojshëm për ne dhe të kete një mbykqyrje ma striktë, si dhe komuna duhet ti kete parasysh shlyrjen e obligimeve që para Eko Higjense kjo do të ishte edhe me e lete ku para qytetarev të kërohet pagesa e borqeve, sa i përket planit është e mirë që do të rritet edhe vedisim i qytetarve për kujdes të ambijetit. Nëse është diqka për të mburrur është që e mira e kësaj jemi një Komunë rurale e që mundem ta kem shum më të pastër dhe të tê têrhjekim vizitorë përmesë viseve te tjera për shfrytëzim, ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit tha: e dim ballafaqimin sa i përkete Ecco Higjenës me problem te ambientit dhe mbeturinave dhe sigurt se edhe projekti i GIZIT do ti ndihmoj dhe tju del ne ndihm dhe t'ju letsoj realizimin

Pasi nuk pat diksutim u hudh në votim Draft Planit për Menaxhimin e Mbeturinave me 9 vota për u votu ky paln dhe pru:

**V E N D I M**

Aprovohet plani Komunal për menaxhimin e mbeturinve

**Pika e pestë: Të ndryshme;**

Kryesuesi tha: qysh edhe e cekem me heret në këtë pik të rendit të ditës do të diskutoj dhe bim vendim për mbushjet elektronike për telefona mobil që edhe këtë vitë te kemi mbushjet, me propozim e fillimit të mbledhejs me shumat e cekura më lartë dhe me 8 vota për dhe nje kundër (Abdyl Gashi) martim këtë:

**V E N D I M**

Aprovohet vendimi për furnizimin e antarëve të Kuvendit Komunal me mbushje telefonike mujore.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi përshendet të pranishmit tha: të pika e rendit të ditë të ndryshmet isha lidhë me problemin e menagjimit të ujësjellsit në Llabajan, para disa ditëve e pam Kryetarin e Komunës që ka nënshkruar një marveshje përmes menagjimin e ujsjellësve në Komunë e Novobërdës aty i pam se të gjitha fshatrat jan në marveshje, po vetem fshati Llabajn nuk e di pse nuk është edhe ky fshat duke e dit që është një fshat i populluar dhe ka problem sa i pëket furnizmit me ujë, z.Nuhi gjithashtu tha se e dim qe ka problem me prona aty ku egziston popmap e ujit, po propozon që të shikohet mundesi e çmimit të ndonj lokacion tjetër si dhe problem tjetër është edhe ndriqimi publik të bëhet një zgjidhej të këti problemi punkryesi i ka lën me defekte këtë ndriqim, gjithashtu është problemi edhe i tregut ku ambijeti po bëhet shum i pa pastër ku prehen pulat dhe lihen mbetjet aty, tregu egzistuës është edhe përball xhamisë dhe afër pishave të këti fashti, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: kërkoi të diskutohet me menaxhimin e qeverisjes lokale ku problemi qendron se ne nuk e dim se kush jan drejtoret e kësaj qeverisje, une kërkoi edhe një mendim të tjerëve përshak që kjo qeverisje nuk ka edhe një pun te vetem për arsy të mos kryrjes se shum punëve, duke e ditë që kjo qeverisje, qeveris me paranë publike dhe vazhdon tutje të keqepërdorë si ky Kryetari që ka sjellje arrogante dhe nuk i jep llogari as kujtë asë kuvendit ase gjykatave, jemi të detyruar edhe të debatojmë dhe ti shfrytëzojm mekanizmat ligjor edhe gjykatata si dhe mejte tjera të informimit që ti tregoj qyetarëve se çka po ndodhë në Komunë tonë, është e pa falshme që një kryetar emron drejtora që jetojn jashtë venditë dhe marrin pagë në Kosovë, është e pa falshme që një kryetar punson gruan e tijë dhe mer pagë dhe nuk paraqitet në vendë të punës, në njëren anë është konflikt interesit, unë nuk e di se në qfar sheti po jetojmë ndoshta fajin nuk është vetëm në nivelin lokal po qëndron edhe atë qendrorë i cili nuk merr masa ndaj një kryetari i cili nuk i përgjigjet ndaj kuvendit, një kryetar i punëson familjaret dhe militant të partis së ti, si do që të jetë na si kuvendë duhete ta bëjm punë ton dhe bashkarisht të kërkojm edhe prej mekanizmave të tjerë një drejtësi një hetuesi ndaj këti kryetari. Mua me vjen keq që sju ka ardh në gjuhën sérbe raporti finansiar vjetorë aty ka shum shkelje marmandëse nuk ka kurfar barazime, ka udhithim jashtë venditë, ka shfrytësim para të cilat jan mjegull nuk dihet asë ku jan asë emrin cili është emru përmbi 33.000€ që se dim asë ku jan shku, prandaj të kërkojm llogaridhënje, se ne jemi legitim nese kryetari nuk është i degjushmë ndaj kuvendi ase edhe ndaj qytetarëve në mbeldhejn e ardhëshem ne do të kërkojm me kërkesa për dhënjen e përgjegjësisë, kurse të çështaj që këkrohët për dhënjen e betimit të këtyre antarëve kjo nuk është kopetencë e jonaj, kjo është KQZ-së ne nuk mundem të bëhem Kryetar shteti.

Milica Jovanovic tha nuk e di se për çfar arsy koleget e leshojn mblejdhen, nuk po e di as diksutimi e tërë kjo është që edhe takimet e kaluar ne nuk i kemi marr në gjuhën sérbe procesverbalin gjithmon e thuani problem teknik, une nuk votoj diqka pa e pas me kohe matrialin, ju that kolegja është pushim, tjetra është që prezent nuk shohim drejtoret nuk di çka është ka ndodhë.

Pasi nuk pat diskutime tjera zv.Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.  
Mbledhja përfundoi në ora 10:49.

Arbenita Llapashtica

Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic  
Kryesues i Kuvendit



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**



**DIREKTORAT BUDZET I FINANSIJE**  
**DREJTORIA BUHET DHE FINANCA**

<b>DATË/A:</b>	20.03.2019
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Skupština Opštine Novo Brdo / Kuvendi Komunes Novobërdë
<b>C.C.C:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	g. Srdjan Todorović - direktor / director
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Izveštaj prenosa neutrošenih sredstava / Raport Bartja e mjeteve te pashpenzuara



Prenos neutrošenih sredstava od 2018 u 2019 godine.

Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2018 në vitin 2019.

**Opština Novo Brdo / Komuna Novobërdë**

Program/ Programi	Kod podprograma / Kodi nenprogramit	Funkcionalni kod / kodi funksional	Izvorni fond / Fondi burimor	Ekonomiska kategorija / Kategoria ekonomike	Ekonomiska podkategorija / Nën kategorit ekonomike	Opis / Pershkrimi	Prenos 2018 / Bartja 2018
Direktorat Zdravstva / Drejtoria Shendetsis	74800	0721	22	13	130	Robe i usluge / Mallra dhe Sherbime	4,999.58 €
Skupstina/ Kuvendit	16930	0111	22	13			1,200.00 €
<b>Robe i usluge / Mallra dhe Sherbime</b>							<b>6,199.58 €</b>
Administracija i osoblje / Administrat dhe Personel	16330	0133	22	14	132	Opštinski troškovi / Sherbime komunale	49.35 €
<b>Opštinski troškovi / Sherbime komunale</b>							<b>49.35 €</b>
Kancelarija Gradonačelnika / Zyra e Kryetarit	16030	0111	22	13	200	Subvencije / Subvencione	6.06 €
<b>Subvencije i transferi / Subvencione dhe transfere</b>							<b>6.06 €</b>
Direktorat Ekonomskog razvoja / Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	48030	0411	22	30	300	Kapitalni troškovi / Shpenzime Kapitale	59,154.31 €
<b>Kapitalni troškovi / Shpenzime Kapitale</b>							<b>59,154.31 €</b>
<b>Ukupno za prenos / Totali per bartje</b>							<b>65,409.30 €</b>